



Australian Embassy
Croatia



Doracak për Gjininë dhe Mjedisin



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center

Falënderim

Qendra Kosovare për Studime Gjinore falënderon ambasadën australiane në Zagreb për mbështetje financiare.

Botuesi: Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Lektorimi & dizajnimi teknik: Arnina Beciri

Shtëpia botuese: Asha Graphics

E drejta e autorit: © Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), maj 2021.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) (www.kgscenter.net) QKSGJ-ja ka kontribuar në integrimin gjinor prej vitit 2002 dhe përpiqet vazhdimisht të arrijë barazi gjinore në Kosovë. Ka qenë nismëtare për arritjen e ndryshimeve në sistemin diskriminues, normave shoqërore dhe standardeve të dyfishta dhe është shumë aktive në monitorimin e institucioneve publike. Misioni i QKSGJ-së është integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha analizat, programet dhe politikat e të gjithë sektorëve të shoqërisë kosovare, përmes ngritjes së vetëdijes dhe përqendrimit në çështje gjinore, zhvillimit të studimeve gjinore dhe duke siguruar përfshirjen e politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor përmes hulumtimeve, zhvillimit të politikave, avokimit dhe lobimit.

Përgjegjësia:

Ky botim është hartuar me financimin e ambasadës australiane në Zagreb. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e QKSGJ-së dhe assesi nuk mund të merret si pasqyrim i pikëpamjeve të ambasadës (qeverisë) australiane.

Përmbajtja

HISTORIKU	4
QËLLIMI I DORACAKUT	5
SHPREHJET DHE PËRKUFIZIMET KRYESORE GJINORE	6
KORNIZAT E POLITIKAVE NDËRKOMBËTARE PËR GJININË DHE MJEDISIN.....	9
RIO DHE KONVENTA KORNIZË E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE.....	9
KORNIZA E HYOGOS PËR VEPRIM	10
KORNIZA KOMBËTARE LEGJISLATIVE E ZBATUESHME PËR GJININË DHE MJEDISIN	10
STANDARDET KRYESORE TË LIDHURA ME GJININË PËR BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE	11
INTEGRIMI GJINOR.....	14
GJINIA DHE ENERGJIA	14
GJINIA DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE	14
GJINIA DHE MENAXHIMI I TOKËS	16
GJINIA DHE KIMIKATET	17
GRATË DHE BURRAT SI AGJENTË TË NDRYSHIMIT	17
INDIKATORËT E MOSTRAVE NË NIVEL TË PËRFUNDIMIT/NDIKIMIT	18
FUQIZIMI EKONOMIK	18
PJESËMARRJA DHE VENDIMMARRJA	19
ZHVILLIMI I KAPACITETEVE	19
PLANIFIKIMI DHE POLITIKAT SEKTORIALE	20
MODELI I BIZNESIT DHE ZGJIDHJET TEKNOLOGJIKE	20
TË MBAJMË MEND	21

Historiku

Degradimi i mjedisit dhe ndryshimet klimatike kanë pasoja të rënda për të gjithë, por në mënyrë të shpërputhur ndikojnë më shumë tek njerëzit e marginalizuar, veçanërisht gratë dhe fëmijët. Në Kosovë, strukturat dhe normat diskriminuese shoqërore dhe kulturore rezultojnë në pronësi dhe qasje të pabarabartë në burime natyrore – të tokës, ujit dhe aseteve prodhuese – si dhe në vendimmarrje të pabarabartë. Kjo kufizon mundësitë e grave për të marrë pjesë, kontribuar dhe përfituar nga politikat për mjedis. Gjithashtu, mundësia e kontributit të grave në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit nuk pranohet mjaftueshëm. Njëkohësisht, mungesa e të kuptuarit dhe adresimit të dimensioneve gjinore brenda politikave dhe projekteve mjedisore çon në humbje të burimeve dhe mund të ketë efekte negative në mirëqenien e familjes, barazinë gjinore dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Pabarazia dhe pengesat specifike gjinore parandalojnë pjesëmarrjen e grave në debate dhe veprime mjedisore në të gjitha nivelet. Krahas qasjes së tyre të pabarabartë në burime, kjo pengon aftësinë e grave për t'ju përshtatur ndryshimeve klimatike dhe për të reaguar ndaj ngjarjeve të tilla si thatësira, degradimi i tokës dhe shpyllëzimi. Gjithashtu, kjo çon në politika mjedisore që nuk marrin parasysh perspektivën gjinore dhe rrjedhimisht ato janë joefektive.

Strategjia e Kosovës për Mjedisin (SMM) 2013-2022 synon të adresojë nevojat aktuale dhe të së ardhmes lidhur me ndryshimet mjedisore. Megjithatë, SMM-së i mungon perspektiva gjinore. Shprehjet si „gra“, „burra“ dhe „gjini“ nuk përmenden në Strategji dhe asnjëri prej sektorëve të trajtuar në të nuk përfshin analizën e ndikimit gjinor. Nuk trajtohen prioritetet, nevojat dhe interesat e ndryshme të grave dhe burrave lidhur me sektorët e energjisë, të ujit, menaxhimit të mbeturinave dhe biodiversitetit. P.sh., gjersa SMM-ja adreson rreziqet nga ndryshimet klimatike, ajo nuk merret me rreziqet e mundshme të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe shëndetësore me të cilat mund të përballen gratë dhe burrat dhe as nuk propozon çfarë veprimesh të merren për zbutjen e këtyre rreziqeve. Për më tepër, Strategjia nuk përmban asnjë indikator ose aktivitete specifike gjinore. Strategjia nuk adreson as nevojat specifike të komunikimit dhe qasjes ndaj grave dhe burrave. Rishikimet e kësaj Strategjie duhet të pranojnë nevojat dhe prioritetet e ndryshme të grave dhe burrave lidhur me ndryshimet dhe degradimin e mjedisit, si dhe rreziqet potencialisht të ndryshme me të cilat gratë dhe burrat mund të përballen, duke përfshirë rreziqet shoqërore, ekonomike dhe shëndetësore. Për ta bërë këtë, duhet të bëhet analiza gjinore. Ky rishikim i Strategjisë mund të bëhet përmes konsultimeve të përshtatshme me gra dhe burra nga fusha të ndryshme, si dhe me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave.

Tronditja socio-ekonomike nga pandemia Covid-19 ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm në ekonominë edhe ashtu të brishtë të Kosovës. Covid-19 vuri në pah nevojat për të përmirësuar kornizën ligjore dhe kapacitetet institucionale, si dhe burimet njerëzore dhe financiare të autoriteteve të mbrojtjes civile lidhur me emergjencat shëndetësore.

Prandaj është thelbësore që t'i kuptojmë këto pabarazi, nevojat e ndryshme, dobësitë, rolet dhe kapacitetet e grave dhe burrave për të arritur zgjidhje më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme mjedisore për njerëzit në Kosovë.

Qëllimi i doracakut

Qëllimi i doracakut është që të na ndihmojë për të kuptuar se çka nënkuptojmë me integrim gjinor nga pikëpamja mjedisore dhe për të udhëzuar se si mund të zbatohet ai në praktikë. Qendra Kosovare për Studime Gjinore shpreson që ky doracak do t'ju ndihmojë aktivistëve të mjedisit dhe të çështjeve gjinore për të kuptuar çka është integrimi gjinor, si dhe të arsyetojë para hisedarëve që janë drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përfshirë në çështjet mjedisore se sa është e rëndësishme që të merret parasysh aspekti gjinor.

Meqenëse veprimet për adresimin e çështjeve mjedisore nuk përfshihen gjithmonë sa duhet në planet kombëtare të zhvillimit dhe programet për zvogëlimin e varfërisë, aktivistët e mjedisit e kanë për detyrë që t'i përfshijnë këto çështje në agjendë. Përveç kësaj, shumë ekspertë të mjedisit kanë përvojë teknike ose shkencore dhe për këtë arsye mund të jenë më pak të ekspozuar ndaj çështjeve gjinore, të cilat më shpesh trajtohen në kontekstin politik dhe shoqëror. Ata mund të mendojnë se koncepti i integritit gjinor nuk është aq i rëndësishëm për punën e tyre dhe për ta natyra e pandashme politike dhe personale e 'trajnitit gjinor' mund të duket e panjohur dhe shqetësuese.

Si reagim ndaj këtyre sfidave, projekti „Gjinia dhe Mjedisi” synon t'i udhëzojë hisedarët dhe të ndërtojë kapacitetet për perspektivën gjinore lidhur me Gjininë dhe Mjedisin. Me këtë projekt shpresojmë të ndihmohen ekspertët të kuptojnë sa e vlefshme është përfshirja e çështjeve gjinore në punën e tyre dhe të shohin integrimin gjinor si mënyrë për të forcuar reagimin dhe qëndrueshmërinë e nismave mjedisore. Doracaku gjithashtu do të jetë i dobishëm për homologët kombëtarë dhe lokalë, agjencitë, parterët ndërkombëtarë dhe të sektorit privat, si dhe ekspertët individualë që punojnë në menaxhimin e mjedisin.

Shprehjet dhe përkufizimet kryesore gjinore

Është e rëndësishme të kaloni kohë të mjaftueshme për t'i diskutuar shprehjet dhe përkufizimet që pjesëmarrësit të kuptojnë mirë domethënien e tyre.

ÇKA ËSHTË GJINIA?

Shprehja 'gjinia' zakonisht i referohet kategorive të ndërtuara shoqërisht që përshkruajnë gratë dhe burrat, shpesh të bazuara në 'seksin' biologjik. Gjinia ka të bëjë edhe me raportet mes grave dhe burrave. Nëpërmjet socializimit, gjinia bëhet faktor strukturor përcaktues në organizimin e çdo shoqërie dhe në pjesëmarrjen në punë prodhuese dhe riprodhuese. Ndërveprimet shoqërore dhe raportet e fuqisë ndërmjet grave dhe burrave kontribuojnë dhe pasqyrojnë role dhe përgjegjësi të ndryshme gjinore, si dhe qasje në burime. Analiza gjinore ofron njohuri për ligjvënësit për të kuptuar dhe rrjedhimisht për t'i zhvilluar politikatat që i marrin parasysh të gjitha këto dallime.

Analiza gjinore zakonisht merr parasysh dallimin midis roleve të ndryshme që gratë dhe burrat i luajnë në shoqëri, duke përfshirë:

- Rolet riprodhuese (detyrat që në baza ditore lidhen me rritjen e fëmijëve dhe punët e shtëpisë).
- Rolet prodhuese (puna e kryer nga gratë dhe burrat e paguar me para të gatshme apo me mall ose shërbime).
- Rolet drejtuese të komunitetit (aktivitete vullnetare dhe të papaguara në nivel të komunitetit).
- Rolet politike (pjesëmarrja në vendimmarrje në të gjitha nivelet politike në emër të zonave zgjedhore të bazuara në interes të përbashkët).

VEPRIMI KLIMATIK Marrja në mënyrë aktive e veprimeve për të zvogëluar emetimet e gazrave serrë, për të promovuar dhe për të forcuar qëndrueshmërinë dhe kapacitetin adaptues ndaj ndikimeve të shkaktuara nga klima. Veprimi klimatik mund të marrë shumë forma, duke filluar nga përfshirja e masave të ndryshme klimatike në politikatat qendrore dhe lokale, deri te rritja e fushatave edukative dhe ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike.

PERSPEKTIVA NDËR-SEKTORIALE Të kuptuarit se ka aspekte të shumta të identitetit (si seksi, orientimi seksual, origjina racore ose etnike, feja, moshja dhe aftësia fizike) që ndër-veprojnë në mënyra komplekse për të ndikuar në atë se si njerëzit e përjetojnë botën. Perspektiva ndër-sektoriale gjithashtu e pranon se ka shumë lloje të diskriminimit dhe pabarazisë që janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe për këtë arsye nuk mund të analizohen ndaras.

NDARJA E BUXHETIT NË ASPEKTIN GJINOR Analiza se si shpenzimet publike dhe ndarja e burimeve kanë ndikim të ndryshim të burrat dhe gratë. Kjo është vegël që ndihmon për të siguruar (ri-)shpërndarje më të barabartë të burimeve publike.

TË DHËNAT E NDARA SIPAS GJINISË Të dhënat që zbërthehen sipas gjinisë dhe rrjedhimisht mund të vënë në pah dallimet ndërmjet grave dhe burrave lidhur me preferencat, sjelljet dhe veprimet shoqërore, politike, ekonomike dhe mjedisore.

EKSPERTIZA GJINORE Të kuptuarit se si gjinia është kategori e identitetit të ndërtuar shoqërisht që formon marrëdhëniet shoqërore, politike, ekonomike dhe hapësinore.

PERSPEKTIVA GJINORE Të kuptuarit se gratë dhe burrat kanë nevoja, përvoja, qasje në burime dhe fuqi të ndryshme, si dhe të kuptuarit e natyrës së ndryshme të jetës, përvojave dhe nevojave të grave në proceset e hartimit dhe vendimmarrjes.

RAPORTET E FUQISË GJINORE Mënyrat se si gjinia krijon dallime në qasje në burime dhe në shpërndarjen e pushtetit në shoqëri.

ROLET GJINORE iu referohen mënyrës se si burrat dhe gratë duhet të veprojnë, mendojnë dhe ndjejnë sipas normave dhe traditave në një vend dhe kohë të caktuar.

KONTROLLI GJINOR mbi burimet dhe proceset vendimmarrëse i referohet dallimeve në mes të të drejtave dhe pushtetit të grave dhe burrave për të vendosur rreth shfrytëzimit të burimeve, përfitimit dhe pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse për shkak të normave dhe vlerave ekzistuese në shoqëri.

AUDITIMET E SIGURISË NGA ASPEKTI GJINOR janë vegla praktike që mund t'i përdorin qytetet për të kuptuar se si gratë dhe burrat e perceptojnë dhe e përjetojnë qytetin ndryshe. Ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për ngacmimet dhe dhunën me baza gjinore në hapësirat publike.

NGACMIMI është sjellje që synon të frikësojë, ndjekë ose detyrojë dikë me forcë duke parashtruar kërkesa ose duke shkaktuar probleme. Në përgjithësi është praktikë e dënueshme që zë vend në kontekst në një mjedis shoqëror që e lejon këtë sepse nuk ka dënim kolektiv ndaj tij. Llojet më të shpeshta janë ngacmimi në vend të punës, ngacmimi kolektiv, psikologjik, ngucakeqja dhe ngacmimi seksual.

DISKRIMINIMI është çdo dallim, përjashtim ose kufizim i bazuar në seks që ka efektin ose qëllimin e dëmtimit ose shfuqizojë pranimin, kënaqësinë, ose përdorimin nga gratë pa marrë parasysh statusin e tyre martesor, të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në çdo sferë politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo ndonjë tjetër.

Normat dhe praktikat gjinore çojnë në ndarje gjinore të punës, që do të thotë, role dhe përgjegjësi të ndërtuara nga shoqëria. Këto role dhe përgjegjësi gjinore krijojnë nivele të ndryshme të qasjes dhe kontrollit, domethënë mundësive të grave dhe burrave për të marrë ose shfrytëzuar burimet (ushqim, kredi, ujë, energji, teknologji, etj.) ose shërbime (arsim, shëndetësi, etj.) Aftësia dhe mundësia për të siguruar burime nuk nënkupton domosdoshmëri që njerëzit do të kenë fuqinë për të kontrolluar përfitimet që rrjedhin nga këto aktivitete. Prandaj, ne duhet të bëjmë dallimin midis „shfrytëzimit” dhe „kontrollit mbi” një burim. Gratë mund të kenë qasje në tokë, farëra, ujë dhe/ose kredi, etj. por jo domosdoshmëri kanë kontroll mbi atë burim. Personi që ka kontroll mbi një burim gjithashtu tenton të jetë vendimmarrës. Personi që ka pushtetin vendimmarrës përforcon lidhjen ekzistuese të pabarabartë të pushtetit, e cila pastaj vë në pah edhe rolet dhe përgjegjësitë e ndërtuara në shoqëri, duke çuar në një cikël të mbrapshtë të stereotipave ekzistuese të ndarjes së punës. Është e rëndësishme të identifikohen pikat hyrëse që varen nga normat dhe praktikat gjinore mbizotëruese në një shoqëri ose kontekst të caktuar. Diçka e tillë kërkon plotësimin e nevojave praktike (nevojave të menjëhershme që mund të plotësohen në një afat të shkurtër) si dhe nevojave strategjike (përtej nevojave praktike, për shembull, ligjet e përbashkëta mund të kenë nevojë të rishikohen para se të arrihet barazia gjinore) si për burrat ashtu edhe për gratë dhe duke u larguar nga pjesëmarrja e thjeshtë drejt pjesëmarrjes dhe fuqizimit kuptimplotë.

Kornizat e Politikave Ndërkombëtare për Gjininë dhe Mjedisin

Në vitin 1979, gjatë Dekadës së parë të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). CEDAW shpesh përshkruhet si një ligj ndërkombëtar i të drejtave të grave dhe është i rëndësishëm për dy arsye kryesore: së pari, afirmon të drejtat riprodhuese të grave; dhe së dyti, vendet që kanë ratifikuar ose aderuar në Konventë janë ligjërisht të detyruara të vënë dispozitat e saj në praktikë. Në mënyrë të ngjashme, ndërsa ka një referencë specifike për gratë rurale, shqetësimet më të gjera mjedisore nuk mbulohen në mënyrë eksplicite brenda kësaj Konvente. Megjithatë, në sesionin e 44-të, Komiteti i CEDAW lëshoi një deklaratë duke konstatuar se barazia gjinore është thelbësore për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e suksesshëm të politikave të ndryshimeve klimatike dhe se të drejtat njerëzore të grave duhet të përfshihen si një parim udhëheqës i përgjithshëm në traktatet e ndryshimeve klimatike.

Dekada për gratë gjithashtu u përcoll nga një sërë nismash të Konferencave Botërore të Kombeve të Bashkuara për Gratë, duke filluar me një takim në Meksikë në vitin 1975, të pasuar nga takimet në Kopenhagë (1980) dhe Najrobi (1985), ku ishin ngritur si çështje veprimet dhe roli i grave në menaxhimin e mjedisit. Takimi i katërt dhe i fundit i plotë u mbajt në vitin 1995 në Pekin, nga ku doli Platforma e Pekinit për Veprim, e cila tani shërben si kornizë për sesionet vjetore për të rishikuar përparimin në një sërë çështjesh, përfshirë mjedisin. Për sa i përket shqetësimeve mjedisore, në Pekin u theksua domosdoshmëria që gratë të përfshihen në mënyrë aktive në vendimmarrje për çështjet mjedisore në të gjitha nivelet, si dhe në integrimin zyrtar të shqetësimeve dhe perspektivave në politikat dhe programet për zhvillim të qëndrueshëm. Fatkeqësitë nuk janë aq në qendër të vëmendjes dhe Platforma e Pekinit thotë se fatkeqësitë natyrore mund të kontribuojnë në degradimin e mjedisit dhe se gratë mund të preken veçanërisht nga fatkeqësitë mjedisore. Nën 'veprimet që duhen ndërmarrë' brenda nevojës për 'të zhvilluar bazën e të dhënave, informacionit dhe sistemeve të monitorimit në aspektin gjinor', sugjerohet se ka nevojë për të monitoruar ndikimin tek gratë e degradimit të burimeve mjedisore dhe natyrore, me një nga faktorët kontribuues të shënuara si fatkeqësi natyrore. Prandaj, fatkeqësitë përfshihen si një faktor kontribuues në degradimin e mjedisit ose si rezultat i kësaj, e jo si një çështje më vete.

Rio dhe Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Konventa për Diversitetet Biologjik (CBD) është një nga traktatet ndërkombëtare mjedisore më së shumti të nënshkuara në botë, me 190 palë nënshkruese. E hapur për nënshkrim në Samitin e Tokës, në Rio de Zhaneiro, në vitin 1992, CBD-ja është korniza ndërkombëtare për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe ndarjen e barabartë të përfitimeve të tij.

Sekretari Ekzekutiv i CBD-së i ka kushtuar rëndësi të madhe faktit se barazia gjinore është parakusht për zhdukjen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Jetesa e popujve ruralë

dhe autoktonë dhe atyre të komuniteteve që jetojnë në varfëri, shpesh lidhen ngushtë me përdorimin dhe ruajtjen e biodiversitetit. Në këto komunitete, gratë luajnë rol udhëheqës në kujdesin për familjet dhe komunitetet e tyre, në ndarjen e kapitalit të tyre intelektual dhe shoqëror dhe në mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve të biodiversitetit. Në shumë shoqëri, gratë dhe burrat janë agjentë të ndryshimit, por kontributet e tyre nuk njihen në mënyrë të barabartë. Barazia gjinore midis grave dhe burrave ka një efekt përmbledhës të përmirësimit të menaxhimit dhe mbrojtjes së biodiversitetit dhe zbutjes së varfërisë për komunitetet.

Korniza e Hyogos për Veprim

Përshkrimi i grave si viktime të ndjeshme është gjithashtu i dukshëm në kornizën ndërkombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë – Kornizën e Hyogos për Veprim (HFA). Qëllimi i përgjithshëm i HFA-së është që të sjellë 'reduktim thelbësor të humbjeve nga fatkeqësitë, në jetë dhe në asetet shoqërore, ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve dhe vendeve'.

Korniza Kombëtare Legjislative e Zbatueshme për Gjininë dhe Mjedisin

Republika e Kosovës në mënyrë strategjike është e orientuar drejt anëtarësimit në BE, prandaj po shqyrton zbatimin e standardeve mjedisore të BE -së dhe është bërë përparim i konsiderueshëm në zhvillimin e legjislacionit në lidhje me Mbrojtjen e Mjedisit në tërësi, përfshirë Mbrojtjen e Ujërave, VNM, VSM, IPPC dhe Mbrojtjen e Natyrës. Përputhshmëria e legjislacionit mjedisor të Kosovës me ligjet e BE -së sigurohet përmes Monitorimit të Progresit në transpozicionin dhe zbatimin e legjislacionit. Viteve të fundit, Kuvendi i Kosovës (KK) (<http://www.assembly-kosova.org>) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) (<https://mmpH.rks-gov.net/en-us/Legislation>) kanë rishikuar dhe miratuar një numër të konsiderueshëm të ligjeve mjedisore dhe kanë bërë përparim të rëndësishëm në përgatitjen e legjislacionit dytësor përkatës (udhëzimeve administrative, urdhrave administrativë dhe rregulloreve ministrore).

Dispozitat mjedisore janë të rrënjosura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës:

Neni 7, pika 1, përcakton mbrojtjen e mjedisit si një nga parimet themelore të rendit kushtetues për Kosovën.

- Neni 52 përcakton të drejtat e qasjes në informacionin mjedisor, pjesëmarrjen e publikut në proceset e vendimmarrjes mjedisore dhe qasjen në drejtësi; këto dispozita janë pjesë thelbësore e legjislacionit mjedisor të BE-së.

Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit

Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtimin
Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore
Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë
Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore

Standardet kryesore të lidhura me gjininë për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave

Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore

Ligji për Barazinë Gjinore i Kosovës, i miratuar në vitin 2015, përcakton masat e përgjithshme dhe specifike për të siguruar dhe mbrojtur të drejtat e barabarta të burrave dhe grave, duke garantuar gjithashtu mundësi dhe trajtim të barabartë në fushat publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë edhe jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet sociale, etj. Gjithashtu siguron përkufizimin e trajtimit të barabartë – si mungesë e diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë bazuar në gjininë dhe promovimin e barazisë gjinore. Ligji është gjithashtu në përputhje me rregullat e Direktivës së KE-së dhe Rregulloren e përcaktuar në direktivën 2006/54/EC mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit.

Sipas Kapitullit III të Ligjit, (Nenet 15, 16, 17, 18, 19) ekzistojnë dispozita specifike që përcaktojnë mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në marrëdhëniet e punës. Në mënyrë të veçantë, nenet adresojnë mbrojtjen nga diskriminimi gjinor në marrëdhëniet e punës që kërkojnë mbrojtje për gratë dhe burrat në bazë të barazisë gjinore në sektorin privat dhe publik. Kërkon kushte për qasje në punësim, vetëpunësim ose profesion, përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe të rekrutimit; qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëzimit profesional, trajnimit profesional; anëtarësimin dhe përfshirjen në një organizatë të punëtorëve ose punëdhënësve; ndalimin e diskriminimit gjinor në skemat e sigurimeve sociale në punë. Gjithashtu, në Ligj përfshihen detyrimet që punëdhënësit duhet të përmbahen nga përfshirja e elementeve të diskriminimit gjinor në shpalljet e vendeve të lira të punës; në marrëdhëniet e punës për të promovuar barazinë gjinore para dhe gjatë marrëdhënies së punës, si dhe sigurimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat për të aplikuar për vende të lira të punës. Ligji gjithashtu bën thirrje për masa afirmative për të adresuar pabarazitë gjinore dhe pjesëmarrjen e ulët të grave dhe burrave në fushat e nën-përfaqësuara të punësimit.

Korniza ligjore dhe politikat e brendshme mbi Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 7, 21 dhe 22

- Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore
- Ligji Nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje
- Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë
- Ligji Nr. 2004/32 për Familjen
- Ligji Nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi
- Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës
- Udhëzimi administrativ i MMPH Nr. 22/2015 për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest
- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, Shtojca
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga zhurma
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Instrumentet kryesore ndërkombëtare për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave:

- Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
- Pakti ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW),
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – Konventa e Stambollit, 2011
- Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe 1820 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe Dhunën kundër Grave,
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
- Agjenda e Kombeve të Bashkuara 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG),
- Deklarata e OKB -së për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave.

Korniza dhe veprimet e zhvillimit në vend për promovimin e Barazisë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave:

- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore,
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit,
- Programi i Reformës Ekonomike,
- Strategjia për rregullim më të mirë,
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat Pronësore,
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve,
- Qarkorja vjetore e buxhetit, dhe
- Strategji të tjera.

Fushat e mundshme për tu analizuar për të identifikuar çështjet që lidhen me gjininë, të rëndësishme për projektet mjedisore:

- Analiza e kornizës së politikave: Detyrimet dhe angazhimet kombëtare për barazinë gjinore siç është Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Platforma e Pekinit për Veprim dhe strukturat institucionale kombëtare për çështjet e grave; angazhimet kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm dhe si gërshetohen këto me angazhimet gjinore.
- Analiza e strukturës institucionale: si është proporcioni i burrave dhe grave në qeverinë qendrore dhe lokale në pozitat vendimmarrëse të lidhura me mjedisin? (p.sh. Ministrat, Drejtorët e Instituteve, Drejtuesit e Departamenteve, Akademia)?
- Analiza sektoriale: cilat janë rolet e grave dhe burrave në sektorë të ndryshëm si pylltaria, uji dhe bujqësia?
- Analiza e politikave, programeve, investimeve dhe iniciativave donatore kombëtare ekzistuese në zonën/sectorin mjedisor. A i përmirësojnë ato përfitimet dhe mundësitë në mënyrë të barabartë për gratë dhe burrat?
- Analiza e kornizës ligjore dhe rregullative: ligjet në lidhje me pronësinë, qasjen dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore. Cila është gjendja ligjore dhe si zbatohen ligjet? (Për shembull, nëse gratë trashëgojnë tokë, a mund ta mbajnë atë ose a pritët që t'ua bartin anëtarëve meshkuj të familjes?)
- Analiza e ndarjeve buxhetore në fushën e mjedisit: A ka pasur ndonjë përpjekje për të analizuar këto buxhete nga perspektiva gjinore? Si ndikon ndarja e buxhetit të burrat dhe gratë?
- Analiza e indikatorëve të mjedisit dhe shëndetit: Cilët indikatorë të mjedisit dhe shëndetit janë gjinorë? (P.sh. a ndryshojnë normat për vdekshmërinë e fëmijëve, lindjen dhe pjellorinë?) Si ndikohen në mënyrë të ndryshme gratë dhe burrat nga ndotja ose degradimi i mjedisit?
- Analiza e stereotipave gjinore dhe normave kulturore. Cilat janë mënyrat në të cilat zbatohen rolet gjinore (të tilla si të mos dukesh duke folur në publik)? Si mund të ndikojë kjo në aftësinë e grupeve të ndryshme për të marrë pjesë në ndërhyrjet e projektit?
- Cilat janë rolet e grave dhe burrave në lidhje me energjinë dhe burimet natyrore (kush grumbullon, kush transporton, kush menaxhon, kush shet produkte)? Sa kohë shpenzohet për këto aktivitete dhe cilat janë të ardhurat relative të grave dhe burrave?
- Analiza e perceptimit të mediave dhe atij publik: Cili është niveli i mbulimit të temave mjedisore dhe gjinore në media? Si mbulohe këto tema? A kanë gratë dhe burrat qasje të barabartë në informacion? Nëse jo, pse?
- Analiza e sektorit joqeveritar: A ka ndonjë organizatë që punon në çështjet gjinore dhe mjedisore? Çfarë ekspertize kanë ato?
- Analiza e nivelit të pjesëmarrjes: A kanë burrat dhe gratë qasje të barabartë në pjesëmarrjen e publikut? Çfarë mund të pengojë/kontribuojë në pjesëmarrjen e tyre?
- Cilat forma të tjera të diskriminimit ndërliohen me gjininë (në bazë të racës/ etnisë, fesë, moshës ose klasës)?

Integrimi gjinor

Gjinia dhe Energjia

Meqenëse qasja në shërbime të përballueshme dhe jo-ndotëse të energjisë është parakusht për arritjen e fuqizimit ekonomik dhe zbutjen e varfërisë, pabarazia në këto aspekte paraqet pengesë për mundësitë ekonomike të grave dhe ka ndikim të konsiderueshëm negativ në familjet dhe komunitetet e tyre. Tradicionalisht, ka prirje që gratë të kenë fuqi të kufizuar vendimmarrëse për blerjet në shtëpi, përfshirë edhe teknologjinë e energjisë elektrike. Meqenëse në shumë fusha, gratë janë ato që më së shumti i përdorin pajisjet e energjisë elektrike, do të ishte e udhës që ato të përfshihen në projektet për dizajn dhe zbatim për t'i përmbushur nevojat e tyre për energji. Gratë tashmë kanë njohuri të vlefshme për kushtet dhe burimet lokale. Edukimi shtesë i grave dhe organizatave të grave për opsionet dhe teknologjinë e energjisë mund të rrisë aftësinë e tyre për të kontribuar në zgjidhjet për energji, përfshirë edhe miratimin e lëndës djegëse dhe pajisjeve të reja dhe më të pastra.

Gratë që mësojnë shkathtësi të reja dhe që fitojnë qasje më të mirë në energji për aktivitetet shtëpiake dhe ato që sjellin të ardhura mund të krijojnë burime të reja për investim me kushte më të mira për vete, familjet dhe komunitetet e tyre.

Disponueshmëria dhe përdorimi i të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë gjithashtu do të ndihmonte procesin e politikave energjetike për t'i përkufizuar këto çështje, për të ekzaminuar alternativat e politikave, për të bërë zgjedhjen e politikave, zbatimin e tyre dhe vlerësimin e rezultateve.

Gjinia dhe Ndryshimet Klimatike

Gjinia përbën aspekt të rëndësishëm që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren, si dhe për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Ndikimi i ndryshimeve klimatike nuk është vetëm fizik dhe ekonomik, por edhe shoqëror dhe kulturor. Për shkak të dallimeve gjinore në rolet dhe përgjegjësitë shoqërore dhe ekonomike, efektet e ndryshimeve klimatike ndikojnë në mënyrë të ndryshme te gratë dhe burrat, me atë që shpesh kanë ndikim më të rëndë te gratë.

Gratë preken më ndryshe dhe më rëndë nga ndryshimet klimatike për shkak të rolit të tyre shoqëror dhe gjendjes sociale më të varfër. Në shumë vende, gratë janë ndër grupet më të prekura për shkak të aftësisë së zvogëluar për qasje në financa, teknologji dhe informatat e domosdoshme për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike. Rritja e shpenzimeve për energji, transport, kujdes shëndetësor dhe ushqim – të shkaktuara nga

efektet dëmtuese të ndryshimeve klimatike – në mënyrë të shpërputhur ndikon negativisht te gratë duke shtuar varfërinë dhe pasigurinë e tyre.

Ndryshimet klimatike mund të kenë ndikim negativ në rendimentet e kulturave bujqësore, rrjedhimisht edhe në jetesën dhe sigurinë e ushqimit të gratë në zonat rurale, të cilat përgjithësisht bartin përgjegjësinë për prodhimin dhe ushqimin e familjes. Furnizimi me ujë dhe lëndë djegëse për familjet, që zakonisht është përgjegjësi e grave, bëhet më i vështirë sepse ndryshimet në mjedis ndikojnë negativisht në furnizimin me ujë të pastër, infrastrukturën ekzistuese dhe në mjediset urbane e rurale. Gratë, si përgjegjësi për familje dhe shtëpi, ka mundësi që do të duhet të përballen më shumë me dëmet e shkaktuara nga ngjarjet ekstreme të motit të lidhura me ndryshimet klimatike. Implikime të rëndësishme kanë edhe dallimet gjinore në qasje në tokë dhe tapi. Megjithatë, gratë mund të japin kontribut të çmueshëm në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përmes rolit të tyre qendror në prodhimin e ushqimit dhe përfshirjen në bujqësi dhe biomasën si burim i energjisë. Përveç kësaj, përvoja dhe njohuria e tyre i bën ato ndër hisedarët kryesorë në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Qëllimet e integritimit gjinor në ndryshimet klimatike janë:

- Për të siguruar që gratë dhe burrat marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje për politikën dhe instrumentet e politikave që synojnë përmirësimin e përshtatjes së kapaciteteve të komuniteteve.
- Për të siguruar që gratë dhe burrat marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje për politikën dhe instrumentet e politikave që synojnë zbutjen e rrezikut të ndryshimeve drastike klimatike dhe shkatërrimit të ekosistemeve në të gjitha nivelet.
- Për të siguruar që të gjitha politikën dhe masat e politikave marrin parasysh ndikimin gjinor nga ndryshimet klimatike.

Kosova ende nuk ka strategji për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Por, Kosova nuk është as nënshkruese e Kornizës së Konventës të OKB-së për Ndryshimet Klimatike dhe rrjedhimisht nuk ka kontribut të përcaktuar kombëtar sipas Marrëveshjes së Parisit të vitit 2015.

Gjinia dhe Menaxhimi i Mbeturinave

Përgjegjësia për menaxhimin e mbeturinave shtëpiake më shumë iu bie grave se sa burrave. Prandaj, aktivitetet trajnuese dhe për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj menaxhimit të mbeturinave shtëpiake duhet posaçërisht të fokusohen te gratë. Heqja e mbeturinave shpesh është pjesë e punës së papaguar të grave, por sapo të bëhet sadopak punë e mekanizuar, si p.sh. përdorimi i karrocave apo tricikletave dhe njëkohësisht bëhet punë me pagesë, atëherë burrat e marrin këtë punë përsipër. Ndërhyrjet në menaxhimin e mbeturinave përfshijnë klasifikimin, riciklimin dhe ripërdorimin e prodhimeve të mbeturinave dhe shpesh mund të sjellin punë me pagesë. Është me rëndësi që gratë, si dhe burrat, të kenë mundësi të zgjedhin nëse duan të përfshihen. Mbeturinave shpesh janë

të kontaminuar në aspektin kimik dhe biologjik. Gjatë trajnimit të grave dhe burrave për menaxhimin e mbeturinave, është me rëndësi që në veprimtaritë ndërgjegjësuëse dhe në kurrikulën e trajnimit të përfshihet edhe njohuria për rreziqet ndaj shëndetit. Burrat dhe gratë mund të kenë qasje të ndryshme ndaj shëndetit publik dhe pastërtisë në komunitet dhe kanë preferenca më se të dallueshme rreth mënyrës së trajtimit të problemeve të shëndetit publik dhe atyre mjedisore. Këto dallime, në nivelin më lokal, kanë ndikim në llojet e shërbimeve që gratë dhe burrat do të dëshironin t'i shohin të zhvilluara në komunitetet e tyre, si dhe sa janë të gatshëm të paguajnë për ato shërbime dhe kush ka përgjegjësinë për të gjetur paratë për të paguar për to nga pjesa e tij/saj e buxhetit familjar. Këto dallime gjithashtu mund të përfshijnë preferencat për politikën, teknologjinë apo qasjen, të cilat kanë ndikim në vendimet që i marrin udhëheqëset apo udhëheqësit, sipërmarrësit, menaxherët dhe autoritetet publike në nivel të ndryshëm. Në Kosovë, shkalla e tanishme e grumbullimit të mbeturinave është 70% dhe më pak se 40% e mbeturinave të ngurta dërgohet në objekte të menaxhuara. Kosova duhet të miratojë masa ligjore dhe praktike për zvogëlimin e mbeturinave dhe rritjen e riciklimit dhe ripërdorimit në përputhje me parimet ekonomike qarkore.

Çështjet dhe pikat kryesore për integrimin thelbësor gjinor në menaxhimin e mbeturinave urbane janë:

- Integrimi i perspektivës gjinore në studimet vlerësuese, planifikuese, zbatuese dhe monitoruese të projekteve për menaxhimin e mbeturinave. Këtu duhet të përfshihet analiza specifike gjinore se sa vlerësohen dhe përdoren mbeturinat dhe burimet në dispozicion.
- Të bëhen këshillime para prezantimit të politikave, procedurave dhe teknologjisë së re, si dhe të ketë përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në këto këshillime.
- Të krijohen mundësi të barabarta për gra dhe burra për të përfituar nga nismat për ndërgjegjësimin dhe trajnimet për menaxhimin e mbeturinave.

Gjinia dhe Menaxhimi i Tokës

Degradimi i tokës sjell zvogëlimin domethënës të kapaciteteve prodhuese të tokës. Aktivitetet njerëzore që i kontribuojnë degradimit të tokës përfshijnë përdorimin e paqëndrueshëm të tokës bujqësore, praktikën e mangëta për menaxhimin e tokës dhe ujit, shpyllëzimi, heqja e vegjetacionit natyror, përdorimi i shpeshtë i makinerisë së rëndë, kullotja e tepërt, rotacioni i mangët i të mbjellave dhe praktikën e këqija të ujitjes. Në degradimin e tokës gjithashtu kontribuojnë edhe fatkeqësitë natyrore, përfshirë thatësirën, vërshimet dhe rrëshqitjen e dheut. P.sh., të dhënat në Kosovë tregojnë se gratë trashëgojnë vetëm 4% nga prindërit e tyre. Vetëm 17% e grave kanë pronë dhe vetëm 18% e grave janë pronare biznesesh, kurse vetëm 3% e të gjitha huave për biznes iu jepen grave. Në Kosovë ende nuk diskutohet për tokën si diçka që gratë duhet ta kenë dhe ende nuk dihet sa gra janë pronare të tokës.

Gjinia dhe Kimikatet

Përpyekjet për të siguruar menaxhim të mirëfilltë të kimikateve në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm kanë dimension të rëndësishëm gjinor. Në jetën e përditshme, gratë, burrat dhe fëmijët iu ekspozohen llojeve të ndryshme të kimikateve me koncentrim të ndryshëm. Niveli i ekspozimit ndaj kimikateve helmuese, si dhe ndikimi pasues në shëndetin e njeriut, përkufizohet nga faktorët socialë, si dhe biologjikë.

Këto efekte negative të kimikateve dhe mbeturinave të rrezikshme në grupet e ndryshme të popullatës dallojnë varësisht nga niveli i ekspozimit, modelet e sjelljes, moshën, efekti biologjik (për shembull, çrregullimi endokrin), vendndodhja gjeografike, gjendja ushqyese dhe bashkë-ekspozimit ndaj kimikateve të tjera. Disa lloje të kimikateve, si p.sh. ndotësit e vazhdueshëm organikë, mund të rriten në nivele të rrezikshme tek njerëzit duke shkaktuar efekte negative riprodhuese, zhvillimore, imunologjike, hormonale dhe kancerogjene me ndikim të ndryshëm në grupet e cenueshme të popullatës.

Gratë shpesh iu ekspozohen më shumë kimikateve dhe mbeturinave si rezultat i roleve të ndryshme socio-ekonomike, të përcaktuara sipas gjinisë. Sipas një studimi në shumë vende, nga gratë ende pritet që të kryejnë shumicën e punëve shtëpiake në dhe përreth shtëpisë, duke përfshirë klasifikimin, largimin dhe hedhjen e mbeturinave shtëpiake, që në shumë raste përfshin djegien në ambient të hapur të plastikës dhe mbeturinave tjera shtëpiake. Kjo praktikë bën që gratë t'iu ekspozohen ndotësve organikë shumë helmues, metaleve të rënda që kanë ndikim të madh në shëndetin e tyre dhe në mundësinë për të pasur fëmijë. Analizat e fundit të pranisë së përgjithshme të kimikateve në trup kanë treguar se këto kimikate barten te fëmijët gjatë shtatzënisë. Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Roterdamit dhe ende nuk ia ka filluar zbatimin të kornizës rregullative për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme. Ende nuk është themeluar linja ndihmëse e as qendra për kontrollin e helmimit kimik.

Gratë dhe burrat si agjentë të ndryshimit

Aktivitetet e grave në prodhimtarinë e ushqimit, menaxhimin e komunitetit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe biodiversitetit, edukimin e fëmijëve dhe kujdesin për familje i vënë ato në qendër të zhvillimit. Ato bëjnë grumbullimin e lëndëve djegëse dhe ujit për familjet e tyre, si dhe shfrytëzojnë energjinë për përgatitjen e ushqimit dhe kujdesin për të sëmurët. Në shtetet në zhvillim, ato angazhohen në mënyrë domethënëse në prodhimtarinë bujqësore, me dhe pa pagesë... Prandaj, pranimi dhe mbështetja e aktiviteteve dhe nevojave të grave janë thelbësore për zhvillimin socio-ekonomik¹.

Shumë aktiviste me të drejtë e vënë në pah se gratë dhe fëmijët preken më së shumti nga efektet e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, është me rëndësi të vihet re se gratë nuk janë të cenueshme për shkak se janë „ më të dobëta për nga natyra”, por për shkak

¹ https://www.greenclimate.fund/sites/default/files/document/guidelines-gcf-toolkit-mainstreaming-gender_0.pdf

se kushtet e cenueshmërisë me të cilat përballen burrat dhe gratë dallojnë për shkak të gjinisë së tyre. Gratë, sikurse burrat, kanë dobësi dhe kapacitete të caktuara të ndërtuara nga shoqëria, të cilat janë zhvilluar përmes procesit të socializimit. Gratë janë të afta për tu përmirësuar, ato mund të fuqizohen dhe të ndryshojnë. Gratë nuk janë pasive; ato nuk presin vetëm për të marrë ndihmë – ato janë agjente aktive me kapacitete të ndryshme për të reaguar ndaj sfidave të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Për këtë arsye, duhet të shmangim stereotipat dhe të mos i shohim gratë (për shkak të seksit të tyre) vetëm si viktima. Gratë dhe burrat përballen me dobësi të ndryshme për shkak të roleve të tyre të ndryshme sociale.

Indikatorët e mostrave në nivel të përfundimit/ndikimit

- Numri dhe përqindja e grave dhe burrave të varfër me qëndrueshmëri të shtuar ndaj ndryshimeve klimatike (p.sh. përdorimi i kulturave dhe teknikave bujqësore të qëndrueshme ndaj klimës, përmirësimi i menaxhimit të tokës, teknologjisë së pastër, rritja e njohurisë dhe forcimi i rrjetit për çështjet e ndryshimeve klimatike, numri/përqindja e shtëpive që udhëhiqen nga gratë me shtëpi të qëndrueshme)
- Numri/përqindja e shtëpive/njerëzve (të udhëhequra nga gratë) me (pa) qasje në energjinë me emetim të ultë të karbonit ose zgjidhje për transport dhe infrastrukturë
- Koha që kursehet në mbledhjen dhe bartjen e ujit, lëndës djegëse dhe prodhimeve të pyjeve për shkak të aktiviteteve të qëndrueshme mjedisore dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike
- Shpenzimet e shtëpive (të udhëhequra nga gratë) për energji (elektricitet)/përqindja e ndryshimit të shpenzimeve për blerje të lëndës djegëse për nevojat energjetike për shtëpi që nevojiten nga gratë
- Numri i viktimave nga fatkeqësitë natyrore sipas gjinisë
- Numri i komuniteteve dhe përqindja e grave në këto komunitete që përfitojnë nga menaxhimi efektiv i qëndrueshëm ndaj klimës
- Numri i rasteve me sëmundje të traktit të frymëmarrjes, helmim nga monoksidi i karbonit dhe aksidenteve me zjarr sipas gjinisë (të rriturit dhe fëmijët)
- Niveli i lëvizjes të grave (p.sh. në raport me transportin me emetim të ultë të karbonit)
- Niveli i dhunës gjinore (p.sh. në raport me mungesën e ndriçimit rrugor)

Fuqizimi ekonomik

- Numri i sipërmarrëseve me qasje të përshtatshme në financim për investime me emetim të ultë të karbonit dhe të qëndrueshëm ndaj klimës
- Numri dhe përqindja e grave dhe burrave me punësim dhe të ardhura në rritje për shkak të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike ose veprimtarive zbutëse (p.sh.

objekte dhe shërbime të përmirësuara për energji, prodhimtari e përmirësuar në bujqësi, etj.)

- Numri dhe përqindja e punës (person-ditë) të gjeneruar për gra dhe burra në komunitet
- Prirja e grave rurale për të punuar jashtë shtëpisë për shkak të elektrifikimit
- Rritja e efikasitetit/prodhimtarisë në punë për shkak të projektit
- Rritja e mundësive në treg për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të udhëhequra nga gratë

Pjesëmarrja dhe vendimmarrja

- Niveli i ndërgjegësimit të grave dhe burrave për të drejtat e grave dhe për rregullat në qasje në burime financiare, natyrore dhe energjike
- Dëshmia që politikat, strategjitë dhe planet bazohen në analiza gjinore të ndikimit të ndryshëm të ndryshimeve klimatike në gratë dhe burrat e varfër, përfshirë objektivat për barazi gjinore për çdo sektor të përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike
- Dëshmia që politikat, strategjitë dhe planet përkatëse sektoriale kërkojnë qasje pjesëmarrëse dhe që i ka cak si gratë, ashtu dhe burrat për përdorim dhe menaxhim të zgjidhjeve dhe teknologjisë me emetim të ultë të karbonit dhe të qëndrueshëm ndaj klimës
- Proporcioni i grave në pozita të larta menaxhuese në ministrinë e linjës

Zhvillimi i kapaciteteve

- Politikat, strategjitë dhe reformat sektoriale përfshijnë objektivat për barazi gjinore bazuar në analizën gjinore të nevojave, kërkesës dhe ofertës
- Numri dhe përqindja e grave dhe burrave të trajnuar në teknologjinë bujqësore të qëndrueshme dhe që kursen energjinë (p.sh. përshtatja ndaj praktikave për menaxhimin e tokës në tokat e margjinalizuara dhe të brishta, përshtatja ndaj moduleve të ndryshuara të reshjeve)
- Ekzistenca e barazisë gjinore të re dhe të përmirësuar që mbështet dokumentet sektoriale rregullative dhe ligjore
- Të dëshmojnë llojet e stimulimit të dizajnuar për rekrutimin e grave, rritjen e kapaciteteve të tyre dhe për të ofruar zhvillim në karrierë në agjencitë e caktuara sektoriale dhe ofruesit e shërbimeve
- Niveli i kapaciteteve institucionale dhe të stafit në integrimin gjinor në sektorët përkatës
- Përqindja minimale e pjesëmarrjes në aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve vjen nga grupet hisedarë të margjinalizuara: gratë dhe pakicat etnike

Planifikimi dhe politikat sektoriale

- Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë të mbledhura dhe të zbatuara në mënyrë të zakonshme në politikat, planet, zbatimin sektorial...
- Të ketë statistika sektoriale të ndjeshme ndaj aspektit gjinor dhe/ose kornizave M&E (baza e të dhënave kombëtare/lokale)
- Të dëshmohet që politikat, strategjitë dhe planet kombëtare/lokale kërkojnë qasje pjesëmarrëse dhe që i kanë cak si gratë, ashtu dhe burrat për përdorim dhe menaxhim të zgjidhjeve dhe teknologjisë me emetim të ultë të karbonit dhe të qëndrueshëm ndaj klimës
- Të dëshmohet që politikat, strategjitë dhe planet përkatëse për aftësimin e sektorit kërkojnë qasje pjesëmarrëse dhe që i kanë cak si gratë, ashtu dhe burrat për përdorim dhe menaxhim të zgjidhjeve me emetim të ultë të karbonit dhe të qëndrueshëm ndaj klimës
- Të dëshmohet që politikat, strategjitë dhe planet në mbështetje të zgjidhjeve me emetim të ultë të karbonit dhe të qëndrueshëm ndaj klimës bazohen në analiza gjinore të ndikimit të ndryshëm të ndryshimeve klimatike te gratë dhe burrat e varfër/gratë dhe burrat nga zonat e largëta rurale dhe përshijnë objektiva, masa, indikatorë dhe caqe për barazi gjinore
- Të bëhet ndarja e buxhetit për masat që mbështesin barazinë gjinore në planifikimin dhe programimin sektorial – buxhetim i përgjegjshëm gjinor
- Të dëshmohet që politikat dhe rregulloret për ndërmarrje të vogla dhe të mesme të gjelbra përfshijnë dispozita që mbështesin barazinë gjinore
- Të ekzistojnë vegla dhe teknika të zbatueshme në praktikë që përfshijnë rolin e gruas në planifikimin dhe konsultimet përkatëse sektoriale
- Numri dhe përqindja e grave dhe burrave (nga zonat e largëta rurale) që ndjekin/përfshihen në mënyrë aktive në takimet sektoriale për planifikim dhe konsultim
- Të ketë gra në strukturën organizative
- Të ketë strukturë/kapacitete institucionale ekzistuese për të adresuar lidhjen ndërmjet gjinisë dhe ndryshimeve klimatike mjedisore

Modeli i biznesit dhe zgjidhjet teknologjike

- Numri dhe përqindja e grave që shfrytëzojnë zgjidhjet me emetim të ultë të karbonit dhe të qëndrueshëm ndaj klimës
- Numri dhe përqindja e grave me mundësi të reja/të përmirësuara për gjenerimin e të ardhurave për shkak të shfrytëzimit të zgjidhjeve me emetim të ultë të karbonit dhe të qëndrueshëm ndaj klimës

Të mbajmë mend

Gratë preken në mënyrë të shpërputhur nga efektet e fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike ku të drejtat dhe statusi socio-ekonomik i tyre nuk është i barabartë me atë të burrave dhe ku ato kanë më pak zë dhe ndikim se burrat për formimin e politikave dhe caktimit të prioritetëve se si do të shfrytëzohen financat për çështje klimatike.

Fuqizimi i grave është përbërës i rëndësishëm për ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj klimës.

Rrugëdaljet përmes zhvillimit të zgjidhjeve me emetim të ultë mund të jenë më efektive dhe më të barabarta kur dizajnohen duke përdorur një qasje të informuar gjinore. Miliarda gra anembanë botës çdo ditë marrin vendime që kanë ndikim në sasinë e karbonit që emetohet në atmosferë.